



“Mos agjëroni para Ramazanit një ose dy ditë, përveç nëse ndokush agjëron (në vazhdimësi) ditë të caktuara, le të agjërojë atë ditë.”

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Mos agjëroni para Ramazanit një ose dy ditë, përveç nëse ndokush agjëron (në vazhdimësi) ditë të caktuara, le të agjërojë atë ditë.”

[Sahih] [Muttefek alejhi]

Profeti ﷺ ua ndaloi muslimanëve të agjërojnë një ose dy ditë para Ramazanit, me qëllimin që të jenë më të sigurt se mos ndoshta Ramazani ka hyrë, sepse obligimi i agjërit të Ramazanit bazohet në shikimin e hënës së re dhe nuk ka nevojë për teprim apo ngarkesë të panevojshme. Megjithatë, nëse dikush ka një agjërim të zakonshëm, siç është agjërimi një ditë duke qenë agjërueshëm, e ditën tjetër jo, (si agjërimi i Davudit) ose agjërimi të hënave dhe të enjteve, dhe një prej këtyre ditëve përkon me këtë kohë (pra, një ose dy ditë para Ramazanit), atëherë ai lejohet të agjërojë. Kjo nuk konsiderohet si parapërgatitje për Ramazan. E njëjta gjë vlen edhe për agjërimet obligative, si kompensimi i ditëve të humbura apo përmbushja e një betimi (pra, lejohen).

<https://sunnah.global/hadeeth/sq/show/4508>

